



# USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 19 (827717)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 7 Maj 2021

## Stërvitja ndërkombëtare ushtarake "Defender Europe 21"



### Kryeministri Rama: Ky është një moment historik për të gjithë ne

"Shqipëria do të vazhdojë të qëndrojë besnikërisht krah për krah jush si një vend që ndoshta nga pikëpamja numerike nuk i ofrojmë shumë kësaj aleance, por nga pikëpamja e vlerave që e bëjnë këtë aleancë unike për botën tonë, ne dëshirojmë të jemi gjithmonë më të denjë e të vyer brenda kësaj aleance". Kështu u shpreh Kryeministri Edi Rama në ceremoninë e organizuar në Portin e Durrësit, në Ditën e Vizitorëve të Shquar për Nder të Stërvitjes Defender 21, ku nisi stërvitja e madhe, me dislokimin që ndodh për herë të parë që prej Luftës së Dytë Botërore, në Europë, ku do të demonstrohen aftësitë... >>> faqe 2

### AMBASADORJA YURI KIM

## Roli i Shqipërisë, më i rëndësishëm se kurrë



>>> faqe 3

## Fillon stërvitja "Defender Europe 21", marrin pjesë tre gjeneralë të NATO-s

# Gjenerali Tod Walters: Shqipëria-një komb që luan rol të madh për paqen në rajon

Komandanti i Komandës Europiane të SHBA-së, Tod Walters: "Shqipëria është eksportuese e siguri! Do të përmirësojmë "muskujt" dhe gatishmërinë në të gjitha aspektet" >>> faqe 3



## Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi

### Kjo stërvitje është një mesazh i qartë për popujt e Ballkanit

Me pjesëmarrjen e veçantë të tre gjeneralëve më të lartë të Aleancës së NATO-s, por edhe të mjaft autoriteteve të larta nisi ditën e martë, më 4 Maj 2021, nga Durrësi stërvitja më e madhe ushtarake në rajonin e Ballkanit Perëndimor, "Defender Europe 21". Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi teksa shprehu mirënjohjen që u zgjodh Shqipëria si një ndër 12 vendet host për...



>>> faqe 2

## Gjeneralmajor Bajram Begaj

### I siguroj gjeneralët amerikanë se nuk gjejnë zhgënjim te ne

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneralmajor Bajram Begaj, mbajti fjalën e tij në nisje të stërvitjes më të madhe ushtarake të NATO-s "Defender Europe 21", në Portin e Durrësit. Gjeneralmajor Begaj vlerësoi zhvillimin e kësaj stërvitjeje të trupave të NATO-s në Shqipëri, ku tha se është e një rëndësie të lartë jo vetëm për përmasat, por edhe për... >>> faqe 4



## JENS STOLTENBERG NATO e palëkundur për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor

MSC. MIMOZA GOLIKJA

>>> faqe 10

### KOLONELI AMERIKAN JOSEPH SCROCCA

### Shqipëri: NATO nis stërvitjen më të madhe në Ballkanin Perëndimor

faqe 5

### 70 VJETORI I KRIJIMIT TË AVIACIONIT USHTARAK SHQIPTAR

### Ministri Peleshi: Forca Ajrore do të pajiset me Helikopterët Black Hawk

faqe 6

# Stërvitja ndërkombëtare ushtarake "Defender Europe 21"

## Kryeministri Rama: Ky është një moment historik për të gjithë ne

"Shqipëria do të vazhdojë të qëndrojë besnikërisht krahu për krahu jush, gjithmonë të denjë brenda kësaj aleance"

"Shqipëria do të vazhdojë të qëndrojë besnikërisht krahu për krahu jush si një vend që ndoshta nga pikëpamja numerike nuk i afrojmë shumë kësaj aleance, por nga pikëpamja e vlerave që e bëjnë këtë aleancë unike për botën tonë, ne dëshirojmë të jemi gjithmonë më të denjë e të vyer brenda kësaj aleance". Kështu u shpreh Kryeministri Edi Rama në ceremoninë e organizuar në Portin e Durrësit, në Ditën e Vizitorëve të Shquar për Nder të Stërvitjes Defender 21, ku nisi stërvitja e madhe, me dislokimin që ndodh për herë të parë që prej Luftës së Dytë Botërore, në Europë, ku do të demonstrohen aftësitë ndërvepruese të Shteteve të Bashkuara me ushtritë partnere të NATO-s, për sigurinë në Ballkanin Perëndimor dhe rajonet e Detit të Zi.

Rama tha se: "është realisht një kënaqësi dhe nder për ne të kemi kaq shumë yje të mbledhura këtu në këtë vend të vogël". Kryeministri shprehu bindjen se kjo stërvitje është shumë, shumë më tepër se sa një moment i rëndësishëm i të gjithë punës së përbashkët në funksion të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve tona, sepse siç tha ai, "besoj se kjo stërvitje është edhe një tjetër pikë e rëndësishme në ngjitjen e mëtejshme të marrëdhënieve tona në pikën më të lartë". "Ne, vijoi ai, vazhdimisht i vlerësojmë këto marrëdhënie si të shkëlqyera, por ato mund të jenë gjithmonë e më të shkëlqyera falë një besimi të madh dhe një ndërveprimi reciprok të vazhdueshëm. Ky është një moment historik për të gjithë ne".

"Gjenerata jonë lindi dhe u rrit me idenë se ju nuk duheshit lënë kurrë të shkelnit në këtë vend. Ne të gjithë u



brumosëm nga propaganda e regjimit të shkuar me bindjen se ju jeni e keqja më e madhe që mund t'i ndodhëjo vetëm Shqipërisë, por mbarë botës. Realisht për gjeneratën tonë është vërtetë një mrekulli e madhe që e ka ndarë jetën

mes dy botëve, asaj të izoluar dhe të errët dhe kësaj bote sot. Dua shumë të besoj që pas zbakimit tuaj në Shqipëri edhe juve do t'ju ndodhë ajo që ju ndodh të gjithëve kur vijnë në Shqipëri që do të doni të riktheheni përsëri. Kush vjen në

Shqipëri dëshiron të kthehet përsëri. Kam shumë dëshirë edhe besim që kjo do të ndodhë edhe me ju", -tha ai.

Kryeministri tha se: "ajo që ne të gjithë së bashku duhet të mbajmë parasysh është detyrimi për t'i përcjellë

gjeneratave të tjera këtë amanet kaq të rëndësishëm për të ardhmen e vendit tonë, por edhe të botës së madhe që kemi zgjedhur, amanetin e kësaj marrëdhënie strategjike për lirinë dhe demokracinë jo vetëm të Shqipërisë, por të mbarë botës duke investuar së bashku të bëjmë më shumë për brezin e ri në të gjitha aspektet. "Duhet t'i japim brezit të ri mundësinë që të edukohet që në krye të herës me vlerat, parimet, standardet shumë të larta të Forcave të Armatosura të NATO-s", -tha Rama. Kryeministri vlerësoi se: "ky është një moment historik për ne të gjithë që na mbush me krenari por edhe me përgjegjësi. Suksese për këtë stërvitje unike në gjithë historinë e marrëdhënieve tona që shpresoj se do të pasohet nga të tjera për t'i dhënë gjithë rajonit një mesazh shumë të qartë, por edhe përtej rajonit, kujtdo që ka nevojë për përgjigje të drejtpërdrejta lidhur me qëndrimin tonë të vendosur brenda kësaj aleance, në krahu të SHBA-së dhe së bashku me të gjitha vendet e tjera që kanë vendosur që për lirinë dhe demokracinë të paguajnë çdo çmim".

### MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI

## Kjo stërvitje është një mesazh i qartë për popujt e Ballkanit



qeverisë shqiptare.

Gjenerali amerikan dhe Komandanti i Komandës Europiane të SHBA, Tod D. Wolters në fjalën e tij përshëndetëse me rastin e nisjes së stërvitjes së NATO-s "Defender Europe 21" në Shqipëri vlerëson vendin tonë si një komb që ka luajtur rol të madh për paqen në rajon. "E gjithë logjistika e anijeve është e përbashkët. E bëjmë në mënyrën tipike të NATO-s, me forca të armatosura të shëndosha: marinsat, forca tokësore, forca ajrore, forca detare, për të provuar e dëshmuar

se nga kjo stërvitje do jemi më shumë përgjegjës, do të reagojmë më mirë. Falënderoj këtë komb, që është eksportues i sigurisë. Mënyra si e kuptojmë këtë, është momenti kur ju e keni treguar këtë nga pranimi në NATO, na ka dhënë një Shqipëri më të sigurt, pjesë perëndimore më të sigurt, një Mesdhe dhe Europë më të sigurt. Ndihe mi më të sigurt, jemi më të fortë së bashku"- tha gjenerali Tod D. Wolters.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri Yuri Kim, në fjalën përshëndetëse përgëzoi Forcat e Armatosura shqiptare dhe Ministrinë e Mbrojtjes për organizimin e ceremonisë së jashtëzakonshme. Diplomatja amerikane tha se Shqipëria është pritëseja e më shumë aktiviteteve se çdo vend tjetër në rajon dhe kjo për një arsye. "Së pari roli i Shqipërisë në Aleancë është më i rëndësishëm se kurrë. Shqiptarët kanë luftuar pranë nesh krahu për krahu në konflikte të shumta përreth globit. Kurrë nuk do të harrojmë sakrificat tuaja, e gjithmonë do t'ju jemi mirënjohës që kur Amerika ka nevojë për ju, kur aleatët kanë nevojë për ju, NATO është aty dhe Shqipëria gjithmonë është krahu nesh. E njohim trimërinë tuaj dhe jemi të nderuar t'ju quajmë aleatët tanë", u shpreh ambasadorja Kim.

Nisja e stërvitjes "Defender Europe 21" u përshëndet edhe nga presidenti Ilir Meta, i cili tha se kjo

stërvitje është një garanci e fortë që Shqipëria është e gatshme të mbrojë vlerat e demokracisë në Europë dhe në të gjithë hapësirën euroatlantike.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj, në fjalën e tij tha se zhvillimi i kësaj stërvitjeje të trupave të NATO-s në Shqipëri është e një rëndësie të lartë jo vetëm për përmasat, por edhe për mesazhet e sigurisë që përcjell. Sipas tij, prania e gjeneralëve të nderuar amerikanë është dëshmi e qartë e mbështetjes së SHBA-së për Forcat tona të Armatosura dhe Shqipërinë. "Shqipëria godet më fort, se sa pesha e saj". I siguroj gjeneralët amerikanë se nuk do të gjejnë zhgënjim te ne", tha gjeneralmajor Begaj. Stërvitja ushtarake, e organizuar nga Ushtria Amerikane në Europë dhe Afrikë, ku marrin pjesë rreth 28 mijë trupa nga 26 vende aleate dhe partnere, do të zhvillohet në 7 baza të ndryshme në vendin tonë. "Defender Europe 21" do të zgjasë deri më 9 qershor. Shqipëria është një nga 16 vendet mirëpritëse në zhvillimin e kësaj stërvitjeje ushtarake. Forcat tona të Armatosura, do të përfaqësohen me rreth 1.000 trupa. Ndërkohë 28.000 trupa shumëkombëshe do të kryejnë aktivitete pothuajse në të njëjtën kohë në më shumë se 30 zona trajnimi, të shtrira në 12 vende.

## Fillon stërvitja "Defender Europe 21", marrin pjesë tre gjeneralë të NATO-s

**G**enerali amerikan dhe Komandant i Komandës Europiane të SHBA-së, Tod Walters ka mbajtur fjalëne tij ditën e martë, më 4 maj 2021, nga Durrësi me rastin e nisjes së stërvitjes së NATO "Defender Europe 21" në Shqipëri. Walters vlerëson Shqipërinë si një komb që ka luajtur rol të madh në paqen në rajon, teksa ka kërkuar që pandemia mos materializohet në krizë sigurie.

Ai thotë se me anë të stërvitjes "Defender Europe 21", vendet aleate të NATO-s përfshirë Shqipërinë do të forcojnë "muskujt" dhe do të përmirësojnë gatishmërinë në të gjitha aspektet. "Është nder të jem këtu sot në Shqipëri, të jem kaq i lumtur në një komb që i trajton të gjithë miqtë e tij si motra e vëllezër, bij dhe bija. Dua t'ju falënderoj ju, një komb kaq i bekuar për atë që ka bërë dhe vijon të bëjë për paqen në rajon. Më lejoni të shpreh ngushëllimet e mia për ata që kanë humbur personat e dashur prej COVID-19. Por edhe për vigjilencën që kjo pandemi mos materializohet në krizë sigurie. Kemi rrugë shumë të gjatë përpara, por nëse keni të dëshmuar, përballë kësaj pandemie do jemi të suksesshëm, sepse kjo pandemi nuk do na çojë në krizë sigurie. Dua të falënderoj autoritetet ushtarake për këtë stërvitje. Sot kemi provën e asaj që duhet të bëjmë, duhet të përmirësojmë transparencën strategjike që nuk është bërë që në 1940.

Teksa qëndrojmë sot në këtë mjedis dhe shohim bregdetin, duhet të kujtojmë çfarëndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pushtimi i Normandisë, zbarkimet në Sicili, D-Day, gjithë

# Gjenerali Tod Walters: Shqipëria-një komb që luan rol të madh për paqen në rajon

*Komandanti i Komandës Europiane të SHBA-së, Tod Walters: "Shqipëria është eksportuese e sigurisë! Do të përmirësojmë "muskujt" dhe gatishmërinë në të gjitha aspektet"*



logjistikat në tokë e det, ne do të ulemi sot e do kuptojmë çfarë prove e vështirë është kjo", -tha gjenerali amerikan dhe Komandant i Komandës Europiane të

SHBA-së, Tod Walters.

Ai tha se: "E gjithë logjistika e anijeve është e përbashkët, jemi këtu sot, është shumë e komplikuar dhe e bëjmë



këtë në mënyrën tipike të NATO-s, me forca të armatosura të shëndosha; marinsa, forca tokësore, detare, për të provuar e dëshmuar se nga kjo stërvitje do të jemi më shumë përgjegjës, do të reagojmë më mirë. "Defender Europe 21", ku marrin pjesë rreth 28 mijë trupa nga 26 vende aleate dhe partnere, dhe qëllimi është të demonstrojmë aftësitë tona kolektive. Dhe nëpërmjet kësaj do të bëjmë stërvitje të përbashkët nga shumë agjenci, forca shumëkombëshe, nga të gjitha

degët kundër një rivali të stimuluar. Do të përmirësojmë muskujt tonë, dhe të përmirësojmë gatishmërinë tonë në të gjitha aspektet. Falënderoj këtë komb, është eksportues i sigurisë. Mënyra si e kuptojmë këtë, momenti kur ju e keni treguar këtë nga pranimi në NATO në vitin 2009 deri më sot, na ka dhënë një Shqipëri më të sigurt, pjesë perëndimore më të sigurt, një Mesdhe dhe Europë më të sigurt. Ndihemi më të sigurt, jemi më të fortë së bashku." - tha gjenerali Tod Walters.

Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim

## Roli i Shqipërisë është më i rëndësishëm se kurrë

**A**mbasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, ka dhënë mesazhin e saj në nisjen e stërvitjes "Defender Europe 21", në Portin e Durrësit. Teksa e ka cilësuar këtë stërvitje si historike, ambasadorja Kim është shprehur se nuk është rastësi që ajo po zhvillohet në Shqipëri. Sipas kryediplomates amerikane, roli i Shqipërisë është më i rëndësishëm se kurrë, pasi shqiptarët kanë ndihmuar SHBA-në në stërvitje rreth e përqark globit.

"Çfarë dite të lavdishme kemi përpara nesh. Ditë historike, ju falënderoj që më ftuat të flas. Dua të përgëzoj FA, ministrin, për organizimin. Dua të them se ushtarët dhe marinarët tanë duken të jashtëzakonshëm. Dua t'ju uroj mirëseardhjen veçanërisht Gjeneralëve Wolters, Harrigian, dhe Cavoli në Shqipëri. Është një rast vërtet i rrallë kur tre gjeneralë amerikanë me katër yje janë në të njëjtin kohë në të njëjtin vend. Jemi të nderuar që bashkohemi me ju në këtë aktivitet për nisjen e stërvitjes "Defender Europe 21". Roli i Shqipërisë në aleancë vetëm rritet. Po të shohësh aktivitetet, vihet re se Shqipëria është pjesëmarrëse më shumë se çdo vend në rajon. Mendoni se është rastësore, por nuk është. Roli i Shqipërisë është më i rëndësishëm se kurrë. Shqiptarët kanë ndihmuar rreth e qark globit. Kurrë nuk do t'i harrojmë



sakrificat tuaja. Shqipëria gjithmonë është krah nesh. E njohim trimërinë tuaj dhe jemi të nderuar t'ju quajmë aleatët tanë.

Shqipëria është një vend i veçantë dhe një vendndodhje strategjike. Si anëtare e Aleancës, Shqipëria ofron një bazë të rëndësishme që i jep mundësinë NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara për t'iu përgjigjur emergjencave dhe krizave rajonale shpejt dhe efektshëm. Stërvitja "Defender Europe 21" përgatit për këtë koncept, demonstron aftësinë për të hyrë në Europën juglindore përmes Shqipërisë,

si dhe vërteton aftësinë e Shqipërisë për të pritur forca shumëkombëshe. Përgëzojmë vullnetin e Shqipërisë për të marrë përgjegjësi. Keni qenë të zëshëm, nuk keni hezituar kurrë të dërgoni trupat tuaja, apo të prisni aleatët në vendin tuaj. Jam kaq mirënjohës për mikpritjen, partneritetin e kurajon tuaj. Kjo stërvitje në Shqipëri është historike. Do të stërvitemi së bashku më shpesh, do të punojmë së bashku më gjerë. Mbetemi me ju, krah për krah, sot, nesër e gjithmonë", -ka deklaruar ambasadorja Kim.

### Stërvitja "Defender Europe 21"



## Tre gjeneralë amerikanë me 4 yje mbërrijnë në Tiranë

**T**re gjeneralë të lartë të ushtrisë amerikane, marrin pjesë në stërvitjen "Defender Europe 21", të cilët janë përshëndetur nga Ambasada Amerikane në Tiranë. "Ne i urojmë mirëseardhjen Gjeneralit Tod Wolters, Komandant i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komandant Suprem i Aleatëve Europian të NATO-s; Gjeneralit Jeffrey Harrigian, Komandant i Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Europë-Forcave Ajrore Afrikë, si dhe Komandës Ajrore Aleate; dhe Gjeneralit Christopher Cavoli, Komandant i Ushtrisë së SHBA në Europë dhe Afrikë. Tri Gjeneralët me katër yje mbërritën sot në Shqipëri për të asistuar në nisjen e "DefenderEurope21", stërvitjes më të madhe ushtarake në Ballkanin Perëndimor", -poston ambasada amerikane në faqen e saj në facebook.

# Stërvitja “Defender Europe 21”

## Ministri Peleshi priti gjeneralin amerikan Christopher Cavoli

*Gjeneral Christopher Cavoli mban postin e komandantit të ushtrisë amerikane në Europë dhe Afrikë*

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti ditën e hënë, me 3 maj, në një takim komandantin e ushtrisë amerikane në Europë dhe Afrikë, gjeneral Christopher Cavoli, në kuadër të stërvitjes “Defender Europe 21”. Teksa i uroi mirëseardhjen në Shqipëri gjeneral Cavolit, ministri Peleshi e njohu atë me masat e marra nga vendi ynë për mbarëvajtjen e kësaj stërvitjeje të rëndësishme. Ministri Peleshi u shpreh besimplotë se kjo stërvitje do të shërbejë si gur themeli për çuarjen përpara dhe intensifikimin e stërvitjeve dypalëshe, Shqipëri-SHBA. Gjithashtu, z. Peleshi konfirmoi gatishmërinë e palës shqiptare jo vetëm për të rritur prezencën në stërvitjet e tjera “Defender Europe 21” jashtë kufijve, por dhe për të mirëpritur serinë e Defender-it '23 dhe '25 në të ardhmen, po në Shqipëri.

Ministri Peleshi falënderoi gjeneral Cavolin për mbështetjen e pakursyer që SHBA-të kanë dhënë dhe vijojnë të japin për modernizimin e Forcave të Armatosura të RSH-së, me qëllim rritjen e nivelit të tyre të gatishmërisë, operacionalitetit dhe ndërveprueshmërisë, për të qenë në lartësinë e sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes të kohës në të cilën jetojmë. Nga ana e tij, gjeneral Cavoli falënderoi vlerësoi maksimalisht masat e marra nga vendi ynë, si vend pritës, për zhvillimin dhe arrijtjen e objektivave të stërvitjes “Defender Europe 21”. Ai nënvizoi rëndësinë që kanë stërvitjet



dhe trajnimet e përbashkëta, të cilat rrisin nivelin e ndërveprueshmërisë ndërmjet aleatëve. Stërvitja “Defender Europe 21” është cilësuar si një mundësi e shkëlqyer që ushtarakët shqiptarë dhe ata amerikanë, të stërviten së bashku në mënyrë që, ata do të jenë të aftë që në të ardhmen të përballojnë sfidat, po së bashku. Më tej, gjeneral Cavoli siguroi ministrin Peleshi se Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë, do të vijojë të

planëzojë dhe zhvillojë stërvitje të përbashkëta me FA-në, si dhe do të mbështesë në vijimësi procesin e modernizimit të tyre. Bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin qëndrim mbi angazhimet e shkëlqyera të Shqipërisë në misionet dhe operacionet e Aleancës, por dhe mbi zhvillimet dhe sfidat e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku Shqipëria luan një rol qendror në reduktimin e influencave dhe përpjekjeve destabilizuese të aktorëve të huaj në rajon.

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ

### I siguroj gjeneralët amerikanë se nuk gjejnë zhgënjim te ne

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneralmajor Bajram Begaj, mbajti fjalën e tij në nisje të stërvitjes më të madhe ushtarake të NATO-s “Defender Europe 21”, në Portin e Durrësit. Gjeneralmajor Begaj vlerësoi zhvillimin e kësaj stërvitjeje të trupave të NATO-s në Shqipëri, ku tha se është e një rëndësie të lartë jo vetëm për përmasat, por edhe për mesazhet që përcjell. Mes të tjerash, Begaj theksoi se përzgjedhja e Shqipërisë për të zhvilluar këtë stërvitje vë në dukje strategjinë e saj, por edhe mundësinë për të testuar të gjitha kapacitetet.

“Ju uroj mirëseardhjen, dhe ju uroj për praninë tuaj. Ndhemi të lumtur dhe krenarë që sot jemi këtu për të shënuar një nga ngjarjet më të rëndësishme të forcave tona. Është e një rëndësie të lartë kjo stërvitje, jo vetëm për përmasat, por edhe për mesazhet që përcjell. Rreth 28 mijë trupa do zhvillojnë njëherazi manovra. Kështu synohet rritja e



gatishmërisë dhe ndërveprueshmërisë së aleatëve të NATO-s dhe vendeve partnere, edhe në kohë të pasigurta, sikundër është pandemia. Kjo stërvitje përbën thelbin e mbrojtjes kolektive. Shqipëria dhe FA-të kanë nderin dhe përgjegjësinë të ofrojnë mikpritjen për këtë stërvitje. Përzgjedhja e Shqipërisë vë në dukje strategjinë e saj, për të testuar të gjitha kapacitetet tona. Do të kemi pamje më të qartë për kryerjen e investimeve strategjike në të ardhmen, për zhvillimin e forcave tona. Ky angazhim i yni është shprehje e besimit të SHBA-së për Shqipërinë dhe NATO-n. Ajo provon se ne jemi të përgatitur për t'u mbrojtur e krijuar stabilitet. Prezenca e gjeneralëve të nderuar amerikanë është dëshmi e qartë e mbështetjes së SHBA-së për Forcat tona të Armatosura dhe Shqipërinë. “Shqipëria godet më fort, se sa pesha e saj”. I siguroj gjeneralët amerikanë se nuk do të gjejnë zhgënjim te ne. Jam mirënjohës ndaj autoriteteve shtetërore për mbështetjen. Besoj se me profesionalizimin dhe përkushtimin tonë do t'i hapim rrugë zhvillimit të aktiviteteve të tjera me këtë përmasë”, -tha gjeneral Begaj.

Stërvitja ushtarake shumëkombëshe “Defender Europe 21”

## NATO shkarkon sasi të mëdha mjetesh ushtarake

Porti i Durrësit ka mirëpritur një fluks të madh kontenjerësh dhe kamionësh të mëdhenj javën që kaloi në prag të stërvitjeve të NATO-s. Fjala është për një përqendrim mjetesh ushtarake që zyrtarët amerikanë thanë se nuk është parë në vendin buzë Adriatikut që nga Lufta e Dytë Botërore. Rreth 700 pajisje nga Skuadra Luftarake e Brigadës së 53-të e Këmbësorisë së Gardës Kombëtare të Floridës po shkarkoheshin nga anija US HNS Bob Hope në Durrës. Ato do të përdoren për dy javë trajnim që përfshijnë deri në 6,000 forca amerikane në gjashtë baza ushtarake shqiptare. Kjo është pjesë e stërvitjeve ushtarake shumëkombëshe Defender-Europe 21 të drejtuara nga ushtria amerikane, të cilat janë përqëndruar në parandalimin e agresionit dhe ruajtjen e gatishmërisë operacionale me NATO-n dhe një numër më të madh aleatësh dhe partnerësh. Ato do të zhvillohen nga 17 maji deri më 2 qershor. “Shqipëria është një partner i vlefshëm. Ushtarakët tanë përfitojnë duke u trajnuar së bashku, duke rritur ndërveprimin, duke ndërtuar gatishmërinë operacionale



dhe duke forcuar marrëdhëniet - të gjitha këto mundësojnë aftësinë tonë për t'iu përgjigjur çdo krize, në çdo kohë, së bashku me aleatët dhe partnerët tanë,” -tha Tammy Muckenfuss e kontingjentit të ushtrisë amerikane për Europën dhe Afrikën, me qendër në Gjermani.

Për majorin Randall Moran, “bashkimi i të gjitha këtyre grupeve është diçka shumë e veçantë”. Zhytësit vazhdojnë të

kontrollojnë thellësinë prej 7 metrash të portit. Por dy anijet mbështetëse logjistike që transportojnë automjetet mund të veprojnë në ujë të cekët dhe po punonin pa ndërprerje për të sjellë pajisjet ushtarake. Një anije ushtarake britanike do të mbërrijë gjithashtu në ditët e ardhshme. Manovrat Defender-Europe këtë vit kanë përfshirë rreth 28,000 forca amerikane, aleate dhe partnere nga 26 vende për të kryer operacione të njëkohshme në më shumë se 30 zona trajnimit në më shumë se 12 shtete, nga Balltiku në Detin e Zi dhe Ballkan.

Përveç ofrimit të gjashtë bazave detare, tokësore dhe ajrore, Shqipëria, anëtare e NATO-s që nga viti 2009, do të angazhojë 1000 trupa në atë që Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e quajti “një ngjarje historike sepse është stërvitja më e madhe në Shqipëri dhe në rajon”. Zyrtarët ushtarakë amerikanë vlerësuan mikpritjen, ushqimin e mirë dhe bukurinë natyrore të Shqipërisë. Zonja Muckenfuss tha se: “Shqipëria ka qenë një mikpritëse mahnitëse dhe i ka mirëpritur të gjithë ushtarakët tanë me ngrohtësi.”

## Ministri Peleshi inspekton përgatitjet e FA-së për “Defender 21”

## Kjo është stërvitja më e madhe e zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri

*Shqipëria do të jetë vendi mikpritës kryesor nga 16 vendet që do mirëpresin zhvillimin e kësaj stërvitjeje ushtarake, e cila ka për qëllim ndërveprimin e aleatëve dhe reagimin në raste krizash*



Koloneli amerikan Joseph Scrocca

## Shqipëria: NATO nis stërvitjen më të madhe në Ballkanin Perëndimor

*Intervistë me Kolonelin Joseph Scrocca, Drejtor për Marrëdhëniet me Publikun në Komandën e Ushtrisë Amerikane në Europë dhe Afrikë, dhënë për DW*



pothuajse në të njëjtën kohë në më shumë se 30 zona trajnimit, të shtrira në 12 vende.

## Cilat janë aktivitetet kryesore?

Koloneli Joseph Scrocca: “Defender Europe 21” do të përfshijë disa manovra dhe aktivitete ushtarake. Kryesoret janë: Përgjigja e Shejtit (1-15 maj 2021) që ka të bëjë me operacione ajrore në Estoni, Bullgari dhe Rumani, ku do të përfshihen më shumë se 7,000 trupa nga 11 vende; Përgjigja e menjëhershme (15 maj-1 qershor), ku më shumë se 5.000 trupa nga 8 vende do të shpërndahen në 31 zona trajnimit në 12 vende të ndryshme për të kryer trajnime dhe për t’u stërvitur për të hapur zjarr realisht. Do të ketë edhe një operacion të përbashkët logjistik në bregdet; Mbrojtja kalorsiake (15 maj- fillim qershor), ku më shumë se 13.000 trupa do të kryejnë gjuajtje reale dhe operacione reale mbrojtëse me raketa si edhe një evakuim mjekësor në shkallë të

gjerë; Stërvitja e Komandës post manovre (qershor 2021), ku afërsisht një personel prej 2.000 vetësh do të bëjë manovra për aftësi të shtabit për të komanduar forca tokësore shumëkombëshe në një mjedis të përbashkët dhe të kombinuar stërvitor, ndërkohë që kryen operacione në botën reale në 104 vende në dy kontinente. “Defender Europe 21” do të ketë edhe dy ngjarje trajnimit shumë të rëndësishme: Luani Afrikan (15 maj -15 qershor), që është ngjarja vjetore më e rëndësishme stërvitore e komandës së ushtrisë amerikane në Afrikë, ku rreth 5.000 vetë, personel ushtarak nga 24 kombe, do të stërviten për gadishmëri mjekësore, do të kryejnë manovra në shkallë të gjerë për të gjuajtur si edhe manovra ajrore dhe detare. Këto manovra do të kryhen kryesisht në Marok; Mbrojtësi i Patundur (15 maj-1 qershor), që është një seri e re e manovrave të NATO-s,

e fokusuar në përforcimin transatlantik të Europës dhe që demonstron aftësinë e NATO-s për t’iu përgjigjur me shpejtësi spektrit të plotë të kërcënimeve.

## Çfarë kërcënimesh dhe krizash potenciale ndaj paqes dhe sigurisë ka aktualishtapo mund të shfaqen, në Europë dhe Detin e Zi?

Koloneli Joseph Scrocca: Situata e sigurisë në Europë është bërë gjithnjë e më komplekse gjatë dekadës së fundit. Ushtria amerikane duhet në të ardhmen të jetë e gatshme të vendosë trupa, të luftojë me vendosmëri dhe të fitojë kundër çdo kundërshtari pothuajse të barabartë, në një konflikt të përbashkët, në shumë fusha dhe me intensitet të lartë. Thënë kështu, “Defender Europe 21” është një stërvitje e përbashkët, shumëkombëshe, mbrojtëse që përfshin forcat aleate dhe partnere. Ajo nuk zhvillohet në përgjigje të ndonjë kërcënimi specifik ose kundërshtari. Ajo dhe stërvitjet e tjera ushtarake që zhvillohen rregullisht të lidhura me të, janë manovra të drejtuara nga SHBA, të dizenuara për të rritur gatishmërinë dhe ndërveprimin me SHBA, aleatët dhe forcat partnere.

## A ka ndonjë paralajmërim nga Rusia apo Irani lidhur me “Defender Europe 21”?

Koloneli Joseph Scrocca: Për të siguruar transparencën, SHBA-të informuan OSBE-në për planet lidhur me zhvillimin e stërvitjes ushtarake “Defender Europe 21” dhe do të vazhdojnë përpjekjet për të ndarë me këtë organizatë koordinimin, shkëmbimin e informacionit, në mënyrë që SHBA-të të përmbushin detyrimet e tyre, që burojnë nga traktati.

## Çfarë kontributi jep Gjermania në “Defender Europe 21”?

Koloneli Joseph Scrocca: Këtë vit pjesa

Begaj, për të parë pikën hyrëse të trupave që do të ulen në pistën e Rinasit. Këtu janë facilitetet e nevojshme për të pritur edhe më pas sipas planit, vazhdon stërvitja. Do të kemi vizita shumë të rëndësishme në ditët në vazhdim nga NATO, nga Komanda Europiane e SHBA-së, Komanda Supreme Operacionale e NATO-s, që siç e thashë puntajnë tek rëndësia dhe mesazhet strategjike të kësaj stërvitjeje për vendin, rajonin por edhe për gjithë Europën.” , - u shpreh ministri Peleshi.

“Defender Europe 21” është një stërvitje e organizuar nga ushtria amerikane në Europë dhe Afrikë dhe parashikohet të marrin pjesë rreth 28 mijë trupa nga 26 vende aleate dhe partnere. Shqipëria do të jetë një nga 16 vendet që do të mirëpresin zhvillimin e kësaj stërvitjeje ushtarake, e cila ka për qëllim ndërveprimin e aleatëve dhe reagimin në raste krizash.

Stërvitja më e madhe ushtarake e 30 viteve të fundit në vendin tonë është gati të ngrëjë siparin. Forcat tona të Armatosura, përveç pjesëmarrjes me rreth 1000 trupa, kanë përgatitur edhe infrastrukturën ndihmëse për pritjen e kolegëve të tyre nga vendet aleate. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi inspektoi ditën e enjte, më 29 prill 2021, pjesën ushtarake të Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” infrastrukturën e përkohshme për pritjen e trupave, duke respektuar edhe masat kundër përhapjes së COVID-19. Ministri Peleshi e konsideroi stërvitjen “Defender 21” si shumë të çmuar për rëndësinë strategjike të Shqipërisë dhe rolin që vendi ynë luan si vend anëtar i NATO.

“Bëhet fjalë për një ngjarje historike sepse është stërvitja më e madhe e ndodhur ndonjëherë në Shqipëri dhe rajon. Është një stërvitje, e cila jep mesazhe të rëndësishme për rëndësinë strategjike të Shqipërisë dhe për rolin që vendi ynë ka dhe do të ketë në të ardhmen në të gjitha zhvillimet gjeopolitike duke patur në krah aleatë shumë të fortë. Partneri ynë më strategjik që, le të themi janë Komanda Europiane e SHBA-së, është organizatore e kësaj stërvitjeje, natyrisht në kuadrin e NATO-s, me pjesëmarrje të madhe të trupave amerikane por edhe të vendeve të tjera pjesë e Aleancës. Ne jemi vend pritës dhe do të marrim pjesë me rreth 1000 efektivë aktivë. Unë sot kam ardhur me shefin e Shtabit të FA-së, gjeneralmajor

Në Shqipëri, NATO ka nisur stërvitjen ushtarake “Defender 21” me mijëra trupa nga SHBA dhe vende të tjera anëtare të saj. Në të marrin pjesë afro 28 mijë trupa nga 26 shtete, ku Shqipëria është pjesëtare dhe një qendër mikpritëse e saj. Koloneli amerikan Joseph Scrocca tha në një takim online me shtypin se Shqipëria është një aleat e vendosur e NATO-s dhe një partner e vlerësuar e sigurisë në nivel rajonal dhe global. Trupat amerikane janë vendosur nga 26 prilli në 5 baza ushtarake të Shqipërisë, tokësore, detare dhe ajrore. Krahas Shqipërisë, në stërvitje marrin pjesë edhe vendet e tjera të Ballkanit perëndimor, anëtarë të NATO-s: Kroacia Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

## Koloneli Scrocca, çfarë synimesh ka stërvitja ushtarake “Defender Europe 21”, që pritet të zhvillohet në fillim të majit dhe do të zgjasë 45 ditë?

Koloneli Joseph Scrocca: “Defender Europe 21” është një stërvitje e përbashkët mbrojtëse shumëkombëshe e drejtuar nga Komanda në Europë dhe ajo në Afrikë e ushtrisë së SHBA-së. Kjo stërvitje synon të ngrëjë gatishmërinë dhe të realizojë ndërveprimin midis ushtrisë së SHBA-së, NATO-s dhe ushtrive partnere, në mënyrë që bashkërisht të jemi të përgatitur për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi. Po ashtu stërvitja ushtarake në fjalë synon të demonstrojë aftësinë e SHBA-së për të shërbyer si një partner strategjik i siguri në rajonet e Ballkanit Perëndimor dhe Detit të Zi, ndërkohë që mbështet aktivitetet tona në Europën Veriore dhe në Afrikë. Mbështetur në suksesin e kësaj stërvitjeje në vitin e kaluar, sivjet “Defender Europe 21” përfshin një numër më të madh kombesh aleate dhe partnere të NATO-s, që kryejnë aktivitete në një zonë më të gjerë sesa ajo që u planifikua në 2020-ën. Stërvitjet ushtarake si “Defender Europe 21” demonstrojnë që angazhimi i SHBA-së ndaj NATO-s është i pathyeshëm, i hekur, që aleatët dhe partnerët e NATO-s janë më të fortë së bashku. Këto stërvitje janë një shembull i shkëlqyer i aftësisë tona kolektive.

## Sa kombe dhe trupa ushtarake do të marrin pjesë në aktivitetet e stërvitjes dhe në sa zona do të shtrihen ato?

Koloneli Joseph Scrocca: Marrin pjesë më shumë se 26 kombe dhe 28.000 trupa shumëkombëshe që do të kryejnë aktivitete

më e madhe e aktiviteteve të “Defender Europe 21” do të zhvillohen në Ballkanin Perëndimor dhe zonat pranë Detit të Zi. Gjithsesi, kemi planifikuar paraprakisht të përdorim portin e Bremerhaven në Gjermani. Por jo si një nga portet kryesore për manovrat ushtarake pasi vetëm një sasi e vogël e pajisjeve do të ngarkohet në Bremerhaven. Parashikojmë gjithashtu përdorimin e aeroporteve në Frankfurt, Nuremberg dhe Ramstein duke filluar nga ky muaj deri në fund të majit. Përveç kësaj, Zona e Trajnimit në Grafenwoehr është planifikuar të përdoret në qershor për Stërvitjen e Komandës post manovre që është një stërvitje e asistuar, e mbështetur nga imitimi në kompjuter për demonstrimin e aftësisë së SHBA-së në kryerjen e operacioneve sulmuese në një mjedis shumëkombësh. Kjo stërvitje do të imitojë një skenar të bazuar në përgjigjen e NATO-s, sipas nenit 5.

## Shqipëria do të jetë vendi kryesor mikpritës i një stërvitjeje kaq gjigande ushtarake. Çfarë prisni nga Shqipëria që të arrihen synimet e manovrës “Defender Europe 21”?

Koloneli Joseph Scrocca: “Defender Europe 21” filloi në Durrës, në javën e parë të majit. Shqipëria do të presë një stërvitje të përbashkët të logjistikës në bregdet, të njohur me inicialet JLOTS (Joint Logistics Over-the-Shore-Logjistikë e përbashkët në bregdet) e cila do t’i mundësojë ekipit të shërbimit amerikan të përdorë anije për të ngarkuar dhe shkarkuar pajisje dhe personel në porte jo të përshtatshme apo të dëmtuara si edhe në plazhe të zhveshura.

Kjo është një ngjarje e rëndësishme, sepse do të jetë hera e parë që një JLOTS ndodh në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore. Ky trajnim historik demonstron aftësinë e Shteteve të Bashkuara për të shërbyer si një partner strategjik i sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe rajonet e Detit të Zi ndërkohë që ne ngremë gatishmërinë operacionale dhe ndërveprimin me aleatët tanë të NATO-s dhe partnerët pjesëmarrës në “Defender Europe 21”, gjë që nxjerr gjithashtu në pah rëndësinë strategjike që ka Porti i Durrësit. Rreth 5.000 forca amerikane do të stërviten dhe veprojnë nga muaji prill deri në qershor, në vende të shumta në Shqipëri, përfshirë bazën ajrore në Kuçovë, në Farkë dhe në zonën e trajnimit në Bizë.

## Kremtohet 70 vjetori i krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar

# Ministri Peleshi: Forca Ajrore do të pajiset me Helikopterët Black Hawk

*Bashkëpunimi i SHBA-së me Forcën Ajrore është i lidhur me helikopterët Black Hawk, trajnimin dhe mirëmbajtjen e radarit, etj.*

Në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas u zhvillua më 29 prill 2021, ceremonia e 70-vjetorit të Krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Në aktivitet ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, përfaqësues të shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë, shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Aviacionit, pilotë, teknikë, instruktorë si dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore. Në fjalën e hapjes, kolonel Ylli Pulaj, kujtoi 24 prillin e vitit 1951 si ditën e ngjarjes së madhe të Krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar dhe rrugën e lavdishme që ka bërë kjo armë e dashur e Forcave të Armatosura në mbrojtje të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe në shërbim e mbështetje të popullsisë në raste të emergjencave dhe përballimit të situatave të vështira.

Në përshëndetjen e tij Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Begaj, tha se: “Në këto shtatë dekada kanë shërbyer me përkushtim, djersë e sakrificë sublimë e të jashtëzakonshme duke shkruar kështu një histori të lavdishme të kësaj arme në historinë e Forcave të Armatosura”. Më tej në fjalën e tij gjeneral Begaj evidentoj rolin e pazëvendësueshëm që Forca Ajrore ka dhënë në situata emergjence, kohë të vështira e kritike, në ndihmë e shpëtim jetësh, kontribute këto, të cilat e kanë bërë aviacionin ushtarak dhe pilotët e tij njerëzit më të dashur.

Ai theksoi se: “Forcat Ajrore dhe aviacioni i saj ushtarak sikurse gjithë Forcat e Armatosura kanë kaluar në procese të domosdoshme dhe të nevojshme reformimi, transformimi dhe zhvillimi në kuadër të zhvillimeve dhe angazhimeve kombëtare euroatlantike dhe punës dhe angazhimit në NATO. Modernizimi dhe zgjerimi i Flotës së Helikopterëve dhe i elementëve të tjerë të Forcës Ajrore, konsolidimi dhe intensifikimi i pregatitjes profesionale me mbështetjen edhe të



Aleatëve tanë do ta bëjë Forcën Ajrore më të fuqishme, më efikase dhe më operacionale.” Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në fjalën e Tij pasi përshëndeti pjesëmarrësit theksoi se: “Sot është një ditë e veçantë për të gjithë ju por edhe për të gjithë ne, për të gjithë shqiptarët,

për të gjithë Shqipërinë sepse jemi në përvjetorin e 70-të, të një prej krenarive të Forcave tona të Armatosura, që është Forca Ajrore. Janë 70 vite të mbushura me guxim, me trimëri, me sakrificë deri në vetmohim”.

Ministri Peleshi kujtoi me nderim

Dëshmorët e Forcës Ajrore, të cilët i janë shtuar altarit të Dëshmorëve të vendit duke theksuar se, ata janë bërë frymëzim për fëmijët dhe të rinjtë, të cilët çdo ditë e më shumë pëlqejnë këtë profesion të vështirë por të bukur.

Në vijim të fjalës së tij, Ministri

Peleshi theksoi faktin se, Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura si anëtare e NATO-s, Aleancës më të madhe politike dhe ushtarake, ka standarte te reja por edhe objektiva për të arritur, dhe për këtë qëllim Ministria e Mbrojtjes ka plane dhe projekte për modernizimin dhe zhvillimin e Forcës Ajrore. Pajisja së shpejti me Helikopterët Black Hawk, përmirësimi i infrastrukturës, sistemeve e kapaciteteve mbështetëse dhe logjistike si dhe trajnimi i pilotëve e teknikëve janë disa nga projektet sfiduese për të ardhmen. Ministri Peleshi evidentoj rëndësinë që NATO i ka dhënë ndërtimit të Bazës Taktike Operacionale në Kuçovë duke vlerësuar jo vetëm pozicionin strategjik të Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor por prezencën e saj rrit dhe konsolidon sigurinë kombëtare. Zhvillimi i Stërvitjes “Defender Europe-21” pjesë e së cilës është edhe Forca Ajrore tregon vlerësim dhe garanci që Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura afrojnë për zhvillime të aktiviteteve kaq të rëndësishme të Aleancës. Aktiviteti u mbyll me një foto të përbashkët dhe një vizitë në ambientet e Garnizonit Rinas e infrastrukturës pritëse për trupat pjesëmarrëse në Stërvitjen “Defender Europe-21”.

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj

## Është dita për të përkujtuar me krenari 24 Prillin e vitit 1951

*Le të punojmë të gjithë së bashku për të çuar më tej emrin e respektuar të Aviacionit Ushtarak Shqiptar dhe Forcës Ajrore*

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj uron me rastin e 70-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar: “Sot, festojmë 70-vjetorin e krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Është dita për të përkujtuar me krenari 24 Prillin e vitit 1951, ditën kur u krye fluturimi për herë të parë i Avionit Ushtarak shqiptar. Në këtë ditë të shënuar, Forca Ajrore kujton dhe nderon me respekt të gjithë atë plejadë profesionistësh, komandantësh, pilotësh, teknikësh dhe personel civil e ushtarak që shërbyen me përkushtim duke e transmetuar dhe kontribuar në breza ngritjen, drejtimin dhe zhvillimin e kësaj arme të dashur të Forcave të Armatosura. Në historikun e Forcës Ajrore janë gdhendur me shkronja të arta emrat e Dëshmorëve të Aviacionit Ushtarak Shqiptar, të cilët dëshmuar dhjetëra akte guximi, trimërie, profesionalizmi e vetëmohimi



duke rënë në krye të detyrës dhe duke mbetur të përjetshëm në breza. Prandaj ne pjesëtarët më të rinj të Forcës Ajrore i kujtojmë me nderim e respekt të thellë të gjithë Dëshmorët e Aviacionit Ushtarak Shqiptar, të cilët janë nderi dhe krenaria jonë. Me rastin e 70-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar, uroj të gjithë

efektivët dhe pjesëtarët e Forcës Ajrore në vite gëzuar festën e 70-Vjetorit. Le të punojmë të gjithë së bashku për të çuar më tej emrin e respektuar të Aviacionit Ushtarak Shqiptar dhe Forcës Ajrore. Na takon ne, që detyrimet ndaj Aleancës t'i çojmë në një stad më të lartë me profesionalizimin e secilit anëtar të Forcës Ajrore!”

Ministri Niko Peleshi

## Baza Ajrore e Kuçovës do të fillojë të ndërtohet brenda këtij viti

Në takimin me drejtuesit ushtarakë e Forcave Ajrore, ministri Peleshi nuk ka lënë pa përmendur edhe investimet e NATO-s për ngritjen e Bazes Ajrore të Kuçovës. “Sot, tha ministri Peleshi, flasim për një bazë taktike të NATO-s në vendin tonë që do të fillojë nga ndërtimi brenda këtij viti e cila është në proces prokurimi dhe po bëhemi gati të fillojmë implementimin. Për pak kohë do të kemi një bazë taktike operacionale të NATO-s: Bazën e Kuçovës e cila i përket Forcave Ajrore. Pra flasim për arritje, flasim për sfida. Kemi sfiden e kualifikimit të pilotëve të rinj. Para pak javësh kemi filluar kursin, në një ceremoni të thjeshtë, kursin për kualifikimin dhe trajnimin e pilotëve. Mbështetemi tek një aleancë shumë e madhe, tek partneret tanë strategjike: Shtetet e Bashkuara të Amerikës që janë pranë nesh si në modernizimin dhe kualifikimin e forcës sonë ajrore”. Ministri Peleshi ka nënvizuar faktin që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj baze jo vetëm për vendin tonë por edhe më gjërë si pjesë e aleancave ushtarake ndërkombëtare në kuadër të NATO-s. Peleshi tha se “Kjo ka lidhje me konsolidimin e Forcës Ajrore Shqiptare edhe në rajon edhe më gjërë, ka lidhje me pozicionimin e lloj lloj erërave që fryjnë në botë, jemi në anën e perëndimit dhe kemi për mision që të përhapim përkrahjen e perëndimit të aleancave euroatlantike aty ku ne kemi rol për të luajtur në Ballkanin Perëndimor”.



## 70-vjetori i krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar

## Me përkushtim, aviacioni ynë ka shkruar një histori të lavdishme

*Gjeneralmajor Bajram Begaj: “Modernizimi, zgjerimi i flotës së helikopterëve dhe konsolidimi e intensifikimi i përgatitjes profesionale të pilotëve, do ta bëjnë Forcën Ajrore një forcë më të fuqishme, më efikase dhe më operacionale”*

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, me anë të një mesazhi, ka uruar pilotët, ushtarakët aktivë dhe në rezervë dhe civilë të Forcës Ajrore, në 70 - vjetorin e krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar, si më poshtë vijon:

“Ky 24 Prill, shënon 70-vjetorin e krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Në këto shtatë dekada, me përkushtim, djersë dhe sakrificë sublime e të jashtëzakonshme, aviacioni ynë ka shkruar një histori të lavdishme. Misioni ushtarak i tij, por veçanërisht angazhimi dhe kontributi i pazëvendësueshëm e fisnik ndër vite për komunitetin dhe jetën e njerëzve të thjeshtë në situata emergjence, në kohë të vështira dhe kritike, në fatkeqësi dhe nevojë, në ndihmë e në shpëtim jetësh, e ka bërë aviacionin tonë ushtarak dhe pilotët e tij, nga njerëzit më të dashur, të nderuar dhe të adhuruar në popull, dhe historinë e tij, pjesë të historisë tonë kombëtare.

Arma e Aviacionit Ushtarak dhe shërbimi në të është fisnik, është krenari, por sfidues, i vështirë dhe me kërkesa e rreziqe të përhershme e të paparashikuara. Dëshmorët e shumtë të saj janë dëshmia e këtyre vështirësive e rreziqeve, por edhe e përkushtimit, dashurisë, kurajës dhe guximit të këtyre profesionistëve. Forca Ajrore dhe Aviacioni i saj Ushtarak, sikurse gjithë Forcat e Armatosura, ka



kaluar në procese të domosdoshme dhe të nevojshme reformimi, transformimi dhe zhvillimi, në kuadër të angazhimeve kombëtare euro-atlantike dhe anëtarësimit në NATO. Siguria për modernizimin dhe zgjerimin e flotës së helikopterëve dhe të elementëve të tjerë të Forcës Ajrore, konsolidimi dhe intensifikimi i përgatitjes profesionale të pilotëve, me mbështetjen edhe të aleatëve tanë, do ta bëjë atë një forcë më të fuqishme, më efikase dhe më operacionale. Në këtë përvjetor, homazhi i parë i nderimit shkon për ata që kanë sakrifikuar jetën në Armën e Aviacionit Ushtarak, dhe një mesazh i veçantë respekti e mirënjohje për të gjithë aviatorët, personelin inxhinier - teknik, ushtarak e civil të kësaj arme ndër vite,

që me punën dhe përkushtimin, passionin dhe dashurinë e treguar, e kthen atë, por edhe figurën e tyre, në një monument krenarie për gjithë Forcat e Armatosura dhe shprese e besimi për të gjitha komunitetet në kohë të vështira dhe nevojë. Edhe në këto kohë të sfidës së madhe kombëtare me pandeminë virusale, pilotët tanë, kudo që ata shërbejnë, vazhdojnë të gjenden dhe t’iu përgjigjen kërkesave dhe emergjencave të kësaj situatë të jashtëzakonshme. Kjo gjendje e bën edhe kujtimin e këtij përvjetori të veçantë dhe të kufizuar përmes shprehjes së urimeve më të mira për të gjithë veteranët, aviatorët aktivë e rezervë, ushtarakë dhe civilë të Forcës Ajrore!”

70 vjet jetë për të mbrojtur hapësirën ajrore të Shqipërisë

## Histori e shkurtër e Forcave Ajrore Shqiptare

Shteti shqiptar bëri përpjekje të shumta për krijimin e armës së Aviacionit luftarak, por për arsye politike një gjë e tillë nuk u arrit dot deri mbas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1945 një grup ish-partizanësh filloi përgatitjen për pilotë luftarakë në shkollën e aviacionit jugosllav. Ky grup përbëhej nga Niko Hoxha, Edip Ohri, Fahri Bubesi, Pertef Myftari, Ibish Vokshi, Zyhd Rada, Sazan Xhelo, Irakli Grazhdani, Masar Aga, etj. Pas prishjes së marrëdhënies mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, grupi e vazhdoi përgatitjen në Bashkimin Sovjetik.

Forcat Ajrore Shqiptare u krijuan zyrtarisht me 24 Prill 1951. Avionët e parë ishin avionë sovjetikë të prodhuar mbas Luftës së Dytë Botërore Yak-18 dhe fillimisht u dislokuan në Laprake në periferi të Tiranës. Pak vite më vonë, Forcat Ajrore Shqiptare do të pajiseshin edhe me avionë luftarakë reaktive. Skuadrilja e parë me avionë luftarakë MIG-58Bis, kodi i NATO-s “Fagot” e titulluar “Peza” u krijua në vitin 1955. Kjo skuadrilje u dislokua në aeroportin e Kuçoves. Në vitet e mëvonshme, në kuadrin e ndihmës ushtarake nga Bashkimi Sovjetik, Forcat Ajrore Shqiptare do të pajisen edhe me avionë luftarakë të tipeve MIG-17, kodi I NATO-s “Fresco” dhe MIG-19, kodi i NATO-s “Ferner”, dhe në fillim të viteve 70-të edhe me avionë luftarakë MIG-21 MIG të prodhimit kinez. Avionët luftarakë që erdhën nga Kina kishin marka prodhimi të ndryshme nga ata sovjetikë, por në Forcat Ajrore Shqiptare, ata u njohën gjithmonë me markën sovjetike të prodhimit. Në qershor 1957 u krijua regjimenti i parë transportues i pajisur me helikopterë Mi-1 (3 copë), helikopterë të rinj Mi-4 (3 copë) si edhe disa avionë me helikë Yak-18 dhe Po-2. Në vitin 1967 ky regjiment u zgjerua në kapacitet me ardhjen e 30 helikopterëve MI-4.



Në vitin 1962 u krijua Regjimenti i Rinasit me avionë luftarakë MIG-17 dhe avione MIG-19. Avionët luftarakë MiG-19 ishin ‘shtylla’ e kësaj force për shkak të numrit të tyre të madh (mbi 70 avione). Po në të njëjtin aeroport u dislokuan për një kohë të shkurtër avionët luftarakë të sapoardhur nga Kina; avionët luftarakë të tipit F-7A “Fishbed C” të cilët ishin versioni kinez i avionit luftarak sovjetik MIG-21F-13 (modeli i parë i prodhuar në masë). Por pas pak kohe këta avionë (12 në numër) u transferuan në bazën ajrore më të re të Forcave Ajrore Shqiptare; ajo e Gjadrit, ndryshe e njohur edhe si Lezha-Zadrima. Avionët F-7A (MiG-21F-13) u grupuan në një skuadrilje. Gjithashtu, baza ajrore e Gjadrit kishte



edhe 2 skuadrilje me avione F-6S (MiG-19) dhe një skuadrilje me avionë F-5 (MiG-17) si edhe disa avionë mësimorë MIG-15UTI dy-vendësh. Baza ajrore e Gjadrit dallohej nga dy bazat e tjera nga

një tunel i nëndheshëm i ndërtuar në malin e Gjadrit. Edhe pse kishte shumë lagështi, ky tunel përbënte një mbrojtje ideale kundër sulmeve ajrore armike. Në periudhën 1950-1975, Forcat Ajrore

Shqiptare ishin një nga forcat ajrore më moderne në rajon, por edhe në botë si për sa i përket pajisjes logjistike, ashtu edhe përgatitjes së lartë të kuadrin që ajo dispononte. Pilotët shqiptarë dalloheshin nga pilotët e tjerë në shkollat e huaja të përgatitjes së pilotëve luftarakë si ato të Jugosllavisë, Bashkimit Sovjetik dhe Kinës për aftësitë e larta profesionale që tregonin. Në vitin 1962, Bashkimi Sovjetik furnizoi Forcat Ajrore Shqiptare me 12 avionë luftarakë MIG-19PM, kodi i NATO-s “Farmer E” të pajisur me radare.

Pas prishjes së marrëdhënies me Bashkimin Sovjetik, Shqipëria u miqësua me Kinen. Qeveria kineze i bëri një propozim qeverisë shqiptare që ti shkëmbej avionët luftarakë MiG-19-PM me një numër më të madh MiG-19S të prodhimit kinez. Ky propozim u pranua nga qeveria shqiptare dhe të 12 MiG-19PM u shkëmbyen me avione më pak të sofistikuar të variantit MiG-19S. Këta avione nuk ishin të pajisur me radarë dhe mund të fluturonin vetëm ditën në kushte optimale atmosferike.

Po në vitin 1962, Akademia e Aviacionit u krijua në Vlorë, akademi e cila kishte statusin e shkollës së lartë. Kjo akademi kishte në dispozicionin e saj, avionë mësimorë për stërvitjen bazë CJ-6 (Jak-18), avionë luftarakë reaktive MIG-15bis dhe avionë mësimorë dy-vendësh MiG-15UTI. Theksojme se Akademia e Aviacionit e hapur në Vlorë në vitin 1962, pati rreth 40 vite jetë, ku dolën shumë pilotë të Forcave Ajrore, por u mbyll pas viteve 1990. Pas viteve 1990 edhe avionët që ishin në përdorim të Forcave Ajrore Shqiptare dolën jashtë përdorimit, për shkak të konsumimit dhe mospërballimit të avionëve moderne që kishte sjellë teknologjia moderne, çka ata u kthyen në objekte muzeale.

# QPR rekruton kandidatë për studime

## Një (1) kandidat për Akademinë Mbretërore të Forcës Tokësore në Britaninë e Madhe

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit ka ndryshuar; afati i ri është deri më 10 maj 2021*

**Q**endra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë 1 (një) kandidat për të ndjekur "Kursin e titullimit të Oficerit të Forcës Tokësore", i cili do të zhvillohet në Akademinë Mbretërore të Forcës Tokësore në Sandhurst, në Britaninë e Madhe, në periudhën 7 qershor 2021-12 gusht 2022. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit ka ndryshuar; afati i ri është deri më 10 maj 2021.

### Kriteret e pranimi të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare. Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykimin penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më shumë se 27 vjeç, në momentin e titullimit (13 gusht 2022, sipas ligjit nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura). Të jetë ushtarak/civil (rekrut, ushtarë, nënoficerë dhe nëntogerë të rinj të cilët nuk kanë kryer kursin bazë të oficerit, ose janë duke ndjekur Kursin e Përgatitjes së Oficerit të Ri), të cilët kanë përfunduar minimumi studimet "bachelor", brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Të ketë kryer shkollën e lartë (minimumi "bachelor") ose të jetë në vitin e fundit të saj. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit të lartë. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet në vitin e fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para. Në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe listën e notave. Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të lartë (bachelor), jo më pak se 7 (shtatë). Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 71 pikë në testimin AL-CPT ose nivelin 2/2/2/2 sipas STANAG 6001. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat. Të ketë aftësi për të notuar deri 100 m. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë akademive ushtarake jashtë vendit, me qëllim pranimin në akademi. Të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose vendore (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë aplikohet për kandidatët që nuk janë pjesë e FA-së. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.

Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit



mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake.

Kandidatët që rekrutohen nga radhët e Forcave të Armatosura përveç kriterëve të mësipërme duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme: a. Të kenë vlerësimin e punës jo më pak se "shumë mirë"; b. Të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: a) Kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit. b) Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë zyrës së pranimi në Qendrën e Personel Rekrutimit, Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në "Kursin e titullimit të Oficerit të Forcës Tokësore", që do të zhvillohet në Britaninë e Madhe. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, ANEX A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë (minimumi bachelor) së bashku me listën e notave.

Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport i aftësisë në punë të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore së



vendbanimit, i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimet

mjekësore për agjentët infektivë (Hepatit B, C dhe D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë,

si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit që plotësohen në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimi në Qendrën e Personel Rekrutimit, për gjendjen shëndetësore dhe për procedim penal ose jo, si dhe është ose jo i dënuar.

### Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar brenda 10 ditëve pas përfundimit të testimit:

Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga gjykata. Vërtetim nga prokuroria. Vërtetim nga përbarimi. Ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Testet për lëndët

narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

### Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj (anglisht) do të zhvillohet më datë 11.05.2021. Testi Fizik do të zhvillohet më datë 11.05.2021. Testi Intelektual do të zhvillohet më datë 12.05.2021, kurse Testi Psikologjik do të zhvillohet më datë 12.05.2021.

### Të dhënat e testimit të Aftësive Fizike:

Meshkujt: Vrapim 800 m, për 4 min e 50 sek (nxemje) dhe 2.4 km për 10 min e 30 sek. Ulje-ngritje mbi krahë (pompa) 44 në 2 min. Shtrirje-ngritje (muskuj barku) 50 në 2 min. Not 100 m. Femrat: Vrapim 800 m, për 4 min e 50 sek (nxemje) dhe 2.4 km për 12 min e 45 sek. Ulje-ngritje mbi krahë (pompa) 21 në 2 min. Shtrirje-ngritje (muskuj barku) 50 në 2 min. Not 100 m.





## QPR rekruton kandidatë për studime

**Pesë (5) kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë**

*Tre bursa për mjekësi, një për oficer tokësor dhe një për oficer detar.  
Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021*

**Q**endra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë, 5 (pesë) të drejta studimi si më poshtë vijon: Shkolla e Studentëve për Oficerë të Forcës Tokësore "EVELPIDON", gjitharmësh, 1 (një) kuotë. Shkolla e Studentëve për Oficerë të Forcës Detare "SND", luftëtar, 1 (një) kuotë. Shkolla e Studentëve për Oficerë të Shërbimeve (të trupës) të Forcave të Armatosura "SSAS", për degën e mjekësisë, 3 (tre) kuota. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021.

**Kriteret e pranimit të kandidatëve:**

Të ketë shtetësi shqiptare. Të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të ketë kryer shkollën e mesme ose të jetë në vitin e fundit të saj. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit të mesëm. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet në vitin e fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para. Në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave. Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, jo më pak se 7 (shtatë). Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat. Të mos jetë i martuar. Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 60 pikë në testimin ALCPT. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim



pranimin në shkolla ushtarake. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit, kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e



studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato, kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më

sipër, s'kualifikohet.

**Dokumentet për regjistrim:**

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shën-

detësore të vendbanimit i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

**Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve:**

Kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve duhet të paraqesin dëshmi penaliteti, vërtetim nga gjykata, vërtetim nga prokuroria, vërtetim nga përbarimi, ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake por edhe testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Datat e testimit:**

Ndërsa aplikanti do të kalojë katër teste në datat e përcaktuara. Kështu testi i gjuhës së huaj (anglisht) do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi fizik do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi intelektual do të zhvillohet më 24 qershor 2021 dhe testi psikologjik do të zhvillohet më 24 qershor 2021.

**Shënim:** Aplikanti duhet të deklarojë se të dhënat e paraqitura në formularët e plotësuar janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



## Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua me Albin Kurtin, kryeministrin e Kosovës në Selinë e NATO-s në Bruksel më 29 prill 2021, për një shkëmbim mendimesh mbi zhvillimet e fundit në Ballkanin Perëndimor. Z. Stoltenberg theksoi mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për përpjekjet për të riaktivizuar bisedimet midis Beogradit dhe Prishtinës, përfshirë përmes procesit të lehtësuar nga BE dhe theksoi se, dialogu mbetet mënyra e vetme për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme politike në Ballkanin Perëndimor. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu theksoi se angazhimi i NATO-s për stabilitetin në të gjithë Ballkanin Perëndimor është i palëkundur. Ai përsëriti se misioni i udhëhequr nga NATO, KFOR, është përqendruar në zbatimin e përditshëm të mandatit të tij që rrjedh nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, domethënë për të siguruar një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt dhe lirinë e lëvizjes për të gjitha komunitetet në Kosovë. Kurse Albin Kurti theksoi rëndësinë e prezencës së NATO-s në Kosovë si dhe shtoi se “anëtarësimi i Kosovës në këtë aleancë do ta bënte rajonin dhe Evropën “më të sigurt”. “NATO është aleanca më e mirë e sigurisë që bota ka parë. Në takim me sekretarin Stoltenberg theksova se prezenca e saj në Kosovë është e domosdoshme për të mbajtur paqen dhe për të ofruar siguri, dhe anëtarësimi i Kosovës në NATO do ta bënte rajonin dhe Evropën më të sigurt”, tha Kurti përmes një postimi në Twitter.

Kurse një ditë më parë, më 28 prill 2021, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, priti në Selinë e NATO-s Presidentin e Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ku Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi kontributet e Maqedonisë së Veriut në sigurinë Euro-Atlantike. “Gjatë vitit të kaluar, Maqedonia e Veriut ka provuar të jetë një ofruar i besueshëm sigurie dhe një aleat i vlerësuar,” tha ai. “Ne duhet të përforcojmë unitetin tonë, të zgjerojmë qasjen tonë ndaj sigurisë dhe të ruajmë së bashku rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Kjo është e rëndësishme në një kohë kur ne shohim kërcënime dhe sfida nga shumë drejtime”, tha ai.

### Spekulimet rreth ndryshimit të kufijve në rajon shtojnë pasigurinë

Në konferencën e përbashkët për shtyp që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, zhvilloi me Presidentin e Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, pas pritjes në Selinë e NATO-s, kur u pyet nga gazetarët lidhur me një “dokumentin jozyrtar” (non-paper) e që kishte në epiqëndër disa ndryshime në kufijtë e Ballkanit, ai tha se nuk e ka parë “dokumentin jozyrtar” (non-paper), lidhur me ndryshimin e kufijve në Ballkan. Por Stoltenberg tha se i ka parë lajmet lidhur me dokumentin non-paper. “Nuk mund të komentoj rreth një dokumenti që nuk e kam parë. Spekulumet rreth ndryshimit të kufijve shkaktojnë pasiguri dhe rrezik për stabilitetin e rajonit. Çdo spekulim në lidhje me këtë është i padobishëm. Për NATO-n e rëndësishme është siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor. Kjo është e rëndësishme për sigurinë e rajonit dhe të Evropës. NATO mbështet stabilitetin e rajonit në mënyra të ndryshme”, tha Stoltenberg.

Por pyetjet për Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s ishin nëse ai kishte ndonjë koment gjithashtu mbi tensionet midis Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, duke qenë se të dy vendet janë anëtarë të Aleancës, (pasi kjo nuk është hera e parë që dy anëtarë të Aleancës shkojnë edhe deri në tensione, duke pasur parasysh Greqinë dhe Turqinë). Pra, “a është kjo një shenjë se mbase diçka nuk është në rregull brenda Aleancës” dhe “nëse NATO po punon për përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe kur bëhet fjalë për Bullgarinë në Maqedoninë e Veriut”. Sekretari i Përgjithshëm, Jens Stoltenberg tha se “NATO është një Aleancë prej 30 aleatësh nga të dy anët e Atlantikut, me histori të ndryshme, parti politike në pushtet dhe gjithmonë ka pasur disa ndryshime midis aleatëve të NATO-s”. Por ajo që kemi parë tha ai është se “NATO është një platformë për aleatët për t’u bashkuar dhe për t’u përfshirë në një dialog konstruktiv dhe NATO promovon dialogun

# NATO e palëkundur për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor

Spekulimet rreth ndryshimit të kufijve shkaktojnë pasiguri dhe rrezik për stabilitetin e rajonit



midis aleatëve kur shohim ndryshime”. Ai gjithashtu kujtoi faktin se “në të vërtetë ishte guximi dhe udhëheqja politike në Shkup, në Sofje dhe në Athinë që bëri të mundur arrijtjen e marrëveshjeve politike për çështjen e emrit dhe çështje të tjera që hapën dyert për Maqedoninë e Veriut për t’u bërë një anëtar i plotë i kësaj Aleance. Sot, Maqedonia e Veriut vlerësohet shumë si aleate e NATO-s”. Sigurisht, ne kemi parë që ka edhe sot disa ndryshime, tha ai, dhe “ajo që ne inkurajojmë është një dialog konstruktiv midis aleatëve për të adresuar dhe zgjidhur këto ndryshime.” Lidhur me letrat jo zyrtare të raportuara, “mbi këto letra në BE në lidhje me ndryshimin e mundshëm të kufijve brenda rajonit” pasi “ka shumë lajme në rajon”, Jens Stoltenberg tha se “nuk më takon mua të komentoj letra, që nuk i kam parë”, por “ajo që ka një rëndësi më të madhe është se çdo spekulim rreth ndryshimit të kufijve vetëm do të shtojë pasigurinë dhe rreziku krijon paqëndrueshmëri në rajon. Kështu që unë mendoj se çdo spekulim rreth kësaj nuk është i dobishëm. Ajo që ka rëndësi për NATO-n është që stabiliteti dhe siguria në Ballkanin Perëndimor është e rëndësishme për sigurisht rajonin, por gjithashtu e rëndësishme për paqen dhe stabilitetin në Evropë dhe për këtë arsye, NATO mbështet fuqimisht stabilitetin në rajon, në mënyra të ndryshme, duke punuar ngushtë me partnerët në rajon, por edhe përmes politikës sonë të detyrë të hapura. Duhet të kujtojmë se ka shumë aleatë të NATO-s në rajon dhe gjatë viteve të fundit, NATO ka pasur privilegjin të mirëpresë dy vende të tjera në rajon si anëtarë të plota të të gjithë Aleancës. Së pari Mali i Zi dhe vitin e kaluar Maqedonia e Veriut. Kështu që ne do të vazhdojmë të punojmë për paqen dhe stabilitetin me partnerët tanë në rajon, natyrisht, me anëtarët tanë në rajon, dhe dialogu konstruktiv dhe respektimi i vazhdueshëm i kufijve të njohur ndërkombëtarë është mënyra më e mirë përpara për stabilitetin dhe sigurinë në rajon.”

### NATO, mbështet dialogun.

### Non-paper nuk është shpërndarë në Selinë e NATO-s

“Cili është pozicioni i NATO-s në lidhje me ndryshimin e kufijve, veçanërisht nëse kjo rivendosje përfshin kufijtë e disa vendeve anëtare të NATO-s? Dhe cili është komenti juaj mbi informacionin që ato dokumente qarkullojnë në Bruksel, midis vendeve anëtare të NATO-s.” Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg theksoi edhe njëherë për gazetarët se “Këto janë dokumente për të cilat i lexoj vetëm në gazeta. Ato nuk janë shpërndarë midis aleatëve

të NATO-s në Selinë e NATO-s. Unë nuk i kam parë. Nuk mund të konfirmoj ekzistencën e këtyre dokumenteve. Pra, këto janë dokumente që unë i kam parë dhe referuar vetëm në media dhe unë kurrë nuk do të komentoj mbi dokumentet që nuk i kam parë ose lexuar vetë. Pra, ky është mesazhi im kryesor për ato dokumente për të cilat nuk është e mundur të thuhet asgjë për sa kohë që nuk i kam parë. Për më tepër në përgjithësi mund të them se ajo që ne besojmë është se NATO luan një rol të rëndësishëm në ndihmën për të stabilizuar rajonin e Ballkanit Perëndimor përmes anëtarëve tanë në rajon, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëria. Dhe sigurisht që kemi edhe vende si Kroacia dhe Sllovenia”, tha Stoltenberg. Ai theksoi se në Ballkanin Perëndimor NATO ka anëtarë por ka dhe partnerët me të cilët punon ngushtësisht dhe mbështet dialogun. “Pra, ka shumë anëtarë në rajon dhe ka edhe partnerë, përfshirë Serbinë, dhe ne po punojmë me Serbinë. Serbia ka deklaruar qartë se ata nuk po kërkojnë anëtarësim në NATO. Ne e respektojmë plotësisht atë. Ne e respektojmë neutralitetin e Serbisë dhe e respektojmë vendimin për të mos kërkuar anëtarësimin në NATO. Por ne e mirëpresim faktin që ne jemi në gjendje të punojmë me Serbinë dhe se Serbia është një partner i NATO-s. Bosnja dhe Hercegovina, një tjetër partner partner dhe aspirant, i cili po punon për integrimin e mëtejshëm Euro-Atlantik. Ne punojmë me Bosnjën dhe Hercegovinën në atë rrugë. Ajo që na duhet është dialogu, dhe për këtë arsye edhe NATO e ka mbështetur dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës për shumë vite. Ne kemi misionin e kujdesshëm atje për të ndihmuar në stabilizimin dhe mbrojtjen e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Dhe ne, sigurisht, mbështesim të gjitha përpjekjet për të bërë përparim në dialogun Prishtinë-Beograd. Nuk i takon NATO-s të rekomandojë më pas se cili duhet të jetë rezultati i këtij dialogu. Ne vetëm mbështesim që palët e përfshira janë ulur së bashku dhe kërkojnë të gjejnë zgjidhje së bashku.”

### “Autorë të non-paper janë fshohur nga turpi për këto ide”

Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Pendarovski tha se ishte politikan i parë rajonal që kishte folur lidhur me rrezikun e ndryshimit të kufijve, kur u pyet nga gazetarët gjatë konferencës për shtyp në Selinë e NATO-s në Bruksel, nëse kishte informacion, se “kush qëndron prapa këtyre dokumenteve dhe me çfarë qëllimi?”, apo “a është e pranueshme për ju një propozim i tillë që të qarkullojë dhe të konsiderohet në Bruksel?”. Ai u përgjigj se “Nuk po

mburrem me faktin se unë isha politikan i parë nga rajoni dy vjet më parë i cili foli me shumë zë të lartë, shumë të qartë, dhe publikisht kundër këtyre shumë, shumë ideve të rrezikshme. Nuk do të doja të humbja kohën e askujt dhe të ndjek krijuesit dhe korrierët, ose lajmëtarët, të këtyre të ashtuquajturave non-paper. Përkundrazi, unë do të doja të pyesja të gjithë njerëzit, të gjitha qeveritë evropiane, çfarë mendojnë ata për këto ide. Unë mund t’ju them nga të gjitha kontaktet që kam pasur dje me funksionarët e lartë brenda Bashkimit Evropian dhe sot me Sekretarin e Përgjithshëm, dhe në baza ditore bilaterale me të gjithë aleatët e tjerë brenda Aleancës së NATO-s, askush, askush nuk dinë gjë”, tha ai lidhur me dijeninë për informacionin. “Unë do të doja ta theksoja se asnjë qeveri nuk po i mbështet këto letra. Vetë fakti që autorët nuk janë të njohur publikisht nga këto letra është një provë e qartë se edhe ata kanë turp për idetë e tyre. Vetëm njerëzit që nuk janë të aftë të prodhojnë ide dhe koncepte krijuese se si të promovojnë interesat kombëtarë të vendeve të tyre dhe si ta bëjnë jetën e njerëzve më të mirë, vetëm ata tip njerëzish po prodhojnë këto lloje të koncepteve, koncepteve letërore zyrtare, duke menduar, duke besuar se nëse i ndanjnë njerëzit përgjatë vijave etnike, atëherë prosperiteti do të vijë brenda natës” tha Pendarovski. Duke folur për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes në një kohë kur Maqedonia e Veriut është përbalhur gjithashtu me një situatë të rënduar të pandemisë së Covid, ai tha se është “çështja më e debatuar gjatë vitit të kaluar nga secila qeveri evropiane, e ndoshta dhe më gjerë se si të gjendet ekuilibri midis shëndetit, duke mbrojtur shëndetin e qytetarëve, i cili është dhe është ende i një rëndësie të madhe për të gjithë. “Ne kemi diskutime të gjata mbi atë çështje, si të shpërndajmë burimet që kemi në dispozicion, dhe shpërndarë ato midis shpenzimeve të mbrojtjes dhe nevojat ekonomike dhe shëndetësore të të gjithë popullsisë. Unë jam më tepër i sigurt se kemi gjetur ekuilibrin e mirë midis këtyre dy zonave, të ndërlidhura ngushtë, do të them, mes njëra-tjetrës. Ne kemi ekzekutuar afërsisht 1 miliard euro për qytetarët tanë dhe njerëzit kryesisht në nevojë në të ashtuquajturat pesë paketa ekonomike gjatë vitit të kaluar dhe në të njëjtën kohë duke rritur buxhetin e mbrojtjes, siç jemi zotuar dy vjet më parë, përpara se të bëhemi anëtar i Aleancës”. Duke ju referuar sondazheve të bëra lidhur me NATO-n, Stevo Pendarovski tha se “ekziston sondazhi i fundit i NATO-s. Unë nuk do të doja t’ju mërzisja me sondazhet e bëra në Maqedoninë e Veriut, por sigurisht një të paanshme të bërë në mënyrë profesionale, duke pyetur

njerëzit se çfarë mendoni për, ose nëse sot ka një referendum për hyrjen në Aleancën e NATO-s, cili do të jetë qëndrimi juaj? Ne kemi qenë midis disa prej shteteve anëtare të vjetra të Aleancës me normën më të lartë të miratimit. Kështu që qytetarët vlerësojnë përpjekjet tona në mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe mbrojtjen e qëndrueshmërisë së sistemit tonë ekonomik, por në të njëjtën kohë, ata nuk po i nënvlerësojnë përpjekjet tona për të mbajtur në gjendje të mirë sistemin tonë të mbrojtjes dhe sigurisë.”

### Po kush është historia e non-paper?

Në “Non-paper Ballkan 2021” proklamohet për “shpërbërjen paqësore” të Bosnjë dhe Hercegovinës dhe aneksimin e pjesëve të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut në një Serbi të Madhe dhe Kroacia e Madhe, si dhe bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës. Mirëpo thuhet gjithashtu se historia e kësaj letre më pas u prish nga faqja boshnjake e internetit, politicki.ba më 12 prill 2021. Planet dhe idetë e dokumentit u kritikuan dhe u reaguashpër nga shumë udhëheqës politikë nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe gjithashtu nga politikanët nga Bashkimi Evropian dhe Rusia. Anëtar i Presidencës Boshnjake Zeljko Komčiq tha që “të gjitha ishin orkestruar tashmë dhe vetëm Zoti e di se cili do të jetë rezultati”. Anëtar tjetër i Presidencës Boshnjake, Šefik Džaferović, dërgoi një letër të shqetësuar për Presidentin e Këshillit Evropian Charles Michel. Nga ana tjetër pasi dëgjoji lajme në lidhje me dokumentin, kryeministri Slloven, Janez Janša foli në një telefonatë me Džaferović, duke deklaruar se “nuk ka asnjë non-paper në lidhje me ndryshimet e kufijve në Ballkanin Perëndimor” dhe shtoi se ai mbështet “integritetin territorial të Bosnjës dhe Hercegovinës”. Kryetari i Këshillit të Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës, Zoran Tegeltija, tha se ai nuk është “një njeri me retorikë inflamtoreshë” dhe se ai “nuk do të merret me letra të trilluara”.

Kurse anëtarja e Parlamentit Evropian për Slloveninë, Tanja Fajon, deklaroi se “idetë në letër janë të rrezikshme, problemet duhet të zgjidhen përmes dialogut.” dhe Presidenti slloven Borut Pahor tha se ai hedh poshtë “idetë e rrezikshme në lidhje me kufirin ndryshimet në Ballkanin dhe se ai nuk dinte” asgjë për non-paper-in”. Kryeministri kroat Andrej Plenković tha se ai “lexoi non-paper-in në një portal në internet, por Kroacia nuk e mori atë.” Ministri rus i Punëve të Jashtme Sergej Lavrov deklaroi se dokumenti “është një lojë e rrezikshme”. Presidenti serb Aleksandar Vučić tha vetëm se “Serbia mund të ndihmojë vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën dhe se ajo nuk ndërhyr në punët brendshme të vendit.” Presidenti malazez Milo Gjukanovic dhe pikëpamjen e tij mbi letrën, duke deklaruar se “është një gjë e rrezikshme, është ofruar nga dikush që dëshiron që lufta të ndodhë sa më shpejt të jetë e mundur”. Nën kryetari i Komisionit Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Josep Borrell, tha se ai “kurrë nuk e mori non-paper-in”, por se ai “dëgjoji për të”. Presidenti i Maqedonisë së Veriut Stevo Pendarovski tha se “çdo ndryshim i kufijve në Ballkanin çon në një gjakderdhje”. Steffen Seibert, zëdhënësi i kancelares gjermane Angela Merkel, thjesht deklaroi se “historitë e ndryshmeve të kufijve në Ballkanin Perëndimor janë shumë të rrezikshme”.

Në koordinim me Organizata Evropiane për Sigurinë e Navigacionit Ajror

**N**ATO testoi me sukses procedurat për të ndjekur me shpejtësi ngritjen ajrore të trupave dhe pajisjeve në të gjithë Evropën në një stërvitje të simuluar të krizës në prill. Testi tre-ditor i nismës së Aleancës “lëvizshmëria e shpejtë në ajër” u mbajt në koordinim të ngushtë me Eurokontrol, Organizata Evropiane për Sigurinë e Navigacionit Ajror.

“Duke lehtësuar lëvizjet më të shpejta të ajrit në të gjithë Aleancën, ne mund të jemi më efektivë në parandalimin e krizave, më efikas në vendosjen e forcave tona dhe më të shpejtë në reagimin kur lindin situata të paparashikuara”, tha Ndhimës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Investimet e Mbrojtjes Camille Grand.

Iniciativa e lëvizjes së shpejtë të NATO-s, ose RAM, është pjesë e përpjekjeve më të gjera të Aleancës për të rritur gatishmërinë e trupave dhe pajisjeve aleate. Avionëve në misionet RAM u caktohet një shenjë unike e thirrjes së NATO-s që e bën më të lehtë lëvizjen përtej kufijve me pajisje, pajisje dhe personel thelbësor, sa më shpejt të jetë e mundur. Në mars 2020, procedurat RAM u aktivizuan për herë të parë për të mundësuar transportin urgjent të pajisjeve mjekësore në përgjigje të pandemisë COVID-19.

Ngjarja, e cila u zhvillua nga 26-28 prill 2021, përfshiu ekspertë nga 12 kombe aleate së bashku me Forcën e Paralajmërimit dhe Kontrollit të Hershëm të Ajrit të NATO-s (AWACS) në një përpjekje për të planifikuar vendosjen e testit të stresit. Si pjesë e stërvitjes, Menaxheri i Rrjetit të Eurokontrol-it, ekipet e planifikimit të fluturimeve të NATO-s dhe NATO-s koordinuan me sukses në vendosjen e simuluar të avionëve aleatë duke lejuar lëvizje më të shpejta ushtarake ndërkontinentale.

# NATO teston me sukses procedurat e Lëvizjes së Shpejtë Ajrore

*Iniciativa e lëvizjes së shpejtë të NATO-s është pjesë e përpjekjeve të Aleancës për të rritur gatishmërinë e pajisjeve dhe truoave ushtarake*



Shefi i Ajrit Marshalli Sir Stuart Peach në Gjeorgji

## NATO mbështet aspiratat e Gjeorgjisë për t'u bashkuar me Aleancën

**M**ë 28-29 prill 2021, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Shefi i Ajrit Marshalli Sir Stuart Peach ishte në Gjeorgji, ku zhvilloi tamime me Presidentin, H.E. Salome Zourabishvili, Kryeministrin H.E. Irakli Garibashvili, Ministrin e Mbrojtjes Juansher Burchuladze dhe Shefin e Mbrojtjes gjeneralmajor Giorgio Matiashevili. Vizita filloi me takimim me shefin e Mbrojtjes, gjeneralmajor Giorgio Matiashevili, dhe pjesëmarrjen në një ceremoni që përkujtonte 30 vjetorin e forcave të mbrojtjes gjeorgjiane. Shefi i Ajrit Marshalli Sir Stuart Peach shprehu admirimin e tij për profesionalizmin dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të treguar nga trupat gjeorgjiane përgjatë misionëve dhe operacioneve të NATO-s. “Trupat gjeorgjiane kanë shërbyer nën flamurin e NATO-s për mbi 20 vjet, duke kontribuar në sigurinë tonë të përbashkët, rajonale dhe ndërkombëtare. Mbatja e fqinjëve tuaj të sigurt dhe të mbrojtur, ndihmon në mbajtjen e njerëzve tuaj të mbrojtur dhe të sigurt”, theksoi Shefi i Ajrit Marshal Peach. Gjatë ceremonisë, Kryetari i Urdhrit Golden Fleece nga Presidenti Gjeorgjian, H.E. Zonja Zourabishvili. Gjatë diskutimit të tyre Kryetari përsëriti angazhimin dhe mbështetjen e gjatë të NATO-s për Gjeorgjinë: “është një çështje krenarie



e madhe personale që ju është dhënë Urdhri Golden Fleece sot. Në emër të Aleancës unë jam thellësisht mirënjohës për popullin e Gjeorgjisë që më dha një nder kaq prestigjioz. Gjatë diskutimeve me Presidentin, Sir Stuart nënvizoi mbështetjen e NATO-s për aspiratat e Gjeorgjisë për t'u bashkuar me Aleancën, përmes Komisionit NATO-Gjeorgji, Programit Vjetor Kombëtar, rolinë e tij si një partner i mundësive të zgjeruara dhe, Paketës Thelbësore NATO-Gjeorgji. “Aleatët kanë vendosur të rrisin më tej paketën. Përbëhet nga 16 aktivitete mbështetëse, që do të kryhen në nivele të ndryshme dhe përmes fushave ajrore, tokësore, detare dhe kibernetike”, vuri në dukje Kryetari. Në takim me kryeministrin gjeorgjian, H.E. Z. Garibashvili, Shefi i Ajrit Marshal Peach u informua për

